



RREGULLORE PËR PUNËN E KUVENDIT TË FSSHRK-së



Në bazë të pikës 6.5 të Statutit të Federatës së Sportit Shkollor, Bordi i FSSHRK-së, në mbledhjen e mbajtur më 13.10.2022, mori vendim për miratimin e rregullores së Këshillit Profesional për shkollat e mesme të ulëta dhe të larta:

RREGULLORE

PËR PUNËN E KUVENDIT TË FSSHRK-së

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1.

Me këtë rregullore parashihet puna e Kuvendit të Federatës së Sportit Shkollor në Kosovë mënyra e realizimit të të drejtave dhe obligimeve të delegatit, si dhe mënyra të çështjeve me interes për punën e kuvendit dhe organeve të tija.

Neni 2.

Me punën e Kuvendit udhëheq kryesia e punës, e cila zgjidhet nga delegatët e Kuvendit. Delegatet e Kuvendit realizojnë të drejtat dhe obligimet e përcaktuara me këtë rregullore Statutin e Federatës së Sportit Shkollor të Republikës së Kosovës

Neni 3.

Kuvendin e hapë Kryetari i kryesisë së punës, i cili para se të propozon rendin e ditës bëhet zgjedhja e komisioneve të nevojshme.

- Procesmbajtës,
- Komisioni verifikues
- Komisioni kandidues

Neni 4.

Komisioni verifikues merr autorizimet e delegatëve, hulumton vërtet-shmërin e tyre dhe paraqet raport para anëtarëve të Kuvendit, e cila në bazë të sajë vërteton kuorumin.



Neni 5.

Nëse Kuvendi nuk e vërteton autorizimin, delegati nuk ka të drejtë votimi për vendimet e Kuvendit.

Neni 6.

Puna e Kuvendit është publike, dhe mund të bien vendime nëse janë të pranishëm më shumë se gjysma e delegatëve (50%+1).

Neni 7.

Në Kuvend kanë të drejtë diskutimi të gjithë të pranishmit, e të drejtë votimi kanë vetëm delegatet.

Neni 8.

Personat që dëshirojnë të diskutojnë, këtë e realizojnë me lejen e kryesisë së punës së kuvendit.

Neni 9.

Diskutuesi ka të drejtë të diskutoj vetëm ato pika që janë në rend të ditës, e nëse largohet prej tyre, kryesuesi ka të drejtë të ja ndalë fjalimin.

Neni 10.

Shqyrtimi i propozimit për ndërrimin dhe plotësimin e statutit mund të bëhet me kërkesën e delegatëve të kuvendit, duke dhënë arsyetim për ndryshime.

Neni 11.

Gjatë diskutimit, delegatet kanë të drejtë me dërgua amendamente me shkrim, derisa propozimi të mos jepet në votim. Amendamentet e aprovuara në kuvend bëhen pjesë përbërëse të statutit. Parimisht votohen në tërësi për dhe kundër si dhe abstenohet.

Neni 12.

Kuvendi vendosë me shumicën absolute për mënyrën e votimit. Votimi bëhet në formë publike apo të fshehur. Votojnë delegatet dhe atë secili në emër të vetë.

Neni 13.

Komisioni kandidues është i obliguar të dorëzojë listën prej më së paku nga një (1) kunderkandidatë



Neni 14.

Komisioni kandidues cakton raportuesin e vetë i cili do ti paraqes Kuvendit raportin mbi listën propozuese.

Neni 15.

Nëse Kuvendi e miraton listën e propozuar prej komisionit kandidues, fillohet me votimi që sipas rregullores janë publike - të fshehura.

Neni 16.

Kandidatet që propozohen më vonë, vihen në listë pas kandidatëve të propozuar prej komisionit kandidues, sipas rendit që propozohen

Neni 17.

Për anëtarë të zgjedhur konsiderohen ata persona që kanë fituar shumicën e votave të anëtarëve të Kuvendit, në rast se nuk fitohet numri i nevojshëm i votave, presim votimin e dytë, dhe pasi të fitohen votat e dhura konsiderojmë se kandidati është i zgjedhur, nëse fiton mbi 50% te anëtarëve qe janë prezent.

Neni 18.

Rezultatet e votave që janë të fshehura, i komunikon raportuesi i komisionit zgjedhorë në bazë të raportit me shkrim. Materialet nga votimet ruhen si të gjitha materialet e Kuvendit.

Neni 19.

Kjo rregullore hynë në fuqi më datën e aprovimit nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Federatës së Sportit Shkollor të Republikës së Kosovës.

Prishtinë

Kryetari i FSSHRK-së

12.10.2022

Adrian TELAKU prof.